



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____ .2021

VENDIM
Nr. 338, datë 04.08.2021

PËR
CAKTIMIN E SEANCËS DËGJIMORE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR FILLIMIN E PROCEDIMIT
DISIPLINOR NDAJ MAGJISTRATIT Z. {...}, ME DETYRË GJYQATAR NË GJYKATËN E
RRETHIT GJYQËSOR VLORË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a pika 1, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 63 të ligjit nr.115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, në nenin 138, pika 2 të Ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në nenin 31, pika 1 dhe 2 të Rregullores, “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori i saj, z.Dritan Hallunaj,

V E N D O S I:

1. Zgjatjen e afatit në caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e procedimit disiplinor nr.4/2021, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj magjistratit z.{...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për shkak të periudhës së pushimeve vjetore.
2. Caktimin e datës 16.09.2021, ora 13.00, si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore, për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR